



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264723

Datë: 01.07.2024

Numri i dokumentit: 05877598

C.nr.4119/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtoresh profesionale K.R. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.H. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **25.06.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit B.H. në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 25 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej **1,383.75** euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 23.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.H. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,383.75 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar është i punësuar si mësimdhënës pranë ShFMU "Xhevat Berisha" në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se paditësit i ka takuar e drejta e kompensimit prej 27% të vlerës së pagës bazë, në bazë të nivelit të

shkollimit. Deri në momentin kur ka kërkuar përmbushjen e këtij obligimi, e paditura ia ka kompensuar shumën prej 58.32 euro, por që është dashur t'i paguhet vlera prej 113.67 euro, pra paditësit nuk i është paguar shuma prej 55.35euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të detyrohet e paditura t'ia kompensojë paditësit shumën që i takon në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8% dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. Gjithashtu ka shtuar se e drejta për kompensim të kualifikimit nga marrëdhënia e punës është parashkruar sipas nenit 53 të LMD-së. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi B.H. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë ShFMU “Xhevat Berisha” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes vërtetimit nr. 275/2021 të datës 18.06.2021, vërtetoi se paditësi për periudhën 17 vjeçare ka qenë i punësuar si mësimdhënës në ShFMU “Xhavit Berisha” në Prizren dhe vazhdon të jetë i punësuar pranë këtij institucioni. Ndërsa, nga kontrata e punës nr.134-2/20 të datës 05.10.2020 e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se kualifikimi i paditësit është fakultet, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma në emër të paditësit.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35euro apo diferencën për 25 muaj nga data 01.01.2021 deri më datë 31.01.2023, në shumë të përgjithshme prej 1,383.75 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep

aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.4119/23 të datës 25.06.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.